



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, 20.05.2021

Bazuar në nenin 92.4 dhe 93.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, nenin 52.1.6, 53 dhe 55 të Ligjit Nr. 05/L-031 të procedurës së përgjithshme administrative, si dhe nenin 8.1.4 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, më datë: 20.05.2021, bie këtë:

V E N D I M

- I. **Anulohet** Thirrja për aplikim për Komunat lidhur me financimin e projekteve kapitale për vitin 2021, nga Programi Komunal për Zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndërkomunal;
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka hapur Thirrjen për aplikim për Komunat lidhur me financimin e projekteve kapitale për vitin 2021 nga Programi Komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndërkomunal. Thirrja në fjalë është publikuar në web site-in e Ministrisë.

Sipas kësaj Thirrje, janë përcaktuar kriteret për financimin e projekteve kapitale në komuna, duke përfshirë por mos u kufizuar në:

- Opinioni i pakualifikuar ose i pakualifikuar me theksim të çështjes nga Zyra kombëtare e auditimit ; 20%
- Së paku 10 mbledhjeve të mbajtura nga kuvendet e komunave, gjatë vitit 2020; (vlerësohet me 20 poena) - 20%

- Funksionimi i komiteteve të përhershme në komunitat (vlerësohet me 20 poena)-20%
- Realizimi i buxhetit për vitin 2020 minimum 50% (vlerësohet me 20 poena)-20%
- Vlerësimi i ligjshmërisë së akteve të jetë në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi (vlerësohet me 20 poena)-20%

Me qëllim që të sigurohet ligjshmëria materiale dhe procedurale e procesit si tërësi, kabineti i Ministrisë ka analizuar hollësisht kriteret e përzgjedhjes dhe ka ardhur në përfundimin vijues:

- a) Përmes Thirrjes, nuk janë përcaktuar kriteret mjaftueshëm të qarta që do të mundësonin përzgjedhjen objektive të përfituesve, në përputhje me parimin e ligjshmërisë, objektivitetit, mosdiskriminimit, transparencës dhe pritshmërisë së arsyeshme, të parapara sipas nenit 4, 6, 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative;
- b) Sipas kriterëve të përcaktuara, nuk është mundësuar që subjektet aplikuese të kenë pozitë të barabartë gjatë procesit të aplikimit dhe të përzgjedhjes;
- c) Nuk është mundësuar realizimi i interesit publik dhe si rrjedhim as përmbushja e misionit ligjor të mjeteve që është planifikuar të alokohen sipas këtij programi;
- d) Nuk janë përcaktuar kriteret e drejta, që do të shërbenin për arritjen e qëllimit të përcaktuar sipas këtij Programi;
- e) Nuk është mundësuar sigurimi i interesit publik dhe shpenzimi efektiv i parasë publik.

Duke vërejtur të metat e mësipërme, të cilat e bëjnë Thirrjen të paligjshme dhe me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrisë;
- Zv. Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit Ligjor; dhe
- Arkivit të Ministrisë.

Elbert KRASNIQI



Ministër